

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "G&A CONSTRUCTION GROUP" SH.P.K

KREU 1

Themelimi , Forma, Emri, Kohëzgjatja, Objekti dhe Selia

THEMELIMI I SHOQËRISË

NENI 1

Duke u bazuar në ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe ne ligjin nr. 131 i datës 26.11.2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ", në përkatësisht: Armand Velaj i biri i Mir dhe i Ganxhe i datëlindjes 28.06.1992, identifikuar nga Nr. Personal J20628090C dhe Gjaneto Harusha i biri i Franc dhe i Enrriketa i datëlindjes 30.05.1981, identifikuar nga Nr. Personal I10530112T nën vullnetin tonë të lirë sot me datë 02.12.2024 nënshkruajmë miratimin e statutit të shoqërisë "**G&A CONSTRUCTION GROUP**" **sh.p.k**

FORMA E SHOQËRISË

NENI 2

Kjo Shoqëri do jetë "Shoqëri Tregtare" e formës "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k) "**G&A CONSTRUCTION GROUP**" **sh.p.k**. Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe atë civil, doganor, tatimor, fiskal dhe akte të tjera ligjore mbi bazën e aktit të themelimit dhe statutit të saj dhe normat e të drejtës ndërkombëtare .

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

NENI 3

Kohëzgjatja e kësaj shoqërie do të jetë pa afat duke filluar nga data 02.12.2024 me marrjen e lejes nga organet kompetente dhe me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar.

Ne rast se brenda 6 muajve nga data e regjistrimit, shoqëria nuk fillon aktivitetin e saj, çdo person i interesuar mund të kërkojë prishjen e marrëveshjeve paraprake.

EMËRTIMI TREGTAR I SHOQËRISË

Kjo shoqëri do të quhet "**G&A CONSTRUCTION GROUP**" **sh.p.k** dhe vula e saj ka formën rrethore në të cilën do shkruhet "**G&A CONSTRUCTION GROUP**" **sh.p.k**.



OBJEKTI I VEPRIMTARISË

NENI 4

Objekti i veprimtarisë ekonomike të kësaj shoqërie është : Import-Eksport dhe Tregtim me shumicë dhe pakicë gipsi, aksesorë gipsi, makineri, materiale e pajisjeve të ndërtimit, vegla pune, aksesorë të ndryshëm për ndërtim, bojë, hidrosanitare, materiale elektrike, materiale hidraulike. Punime të ndryshme gipsi dhe ndërtimi.

Këto aktivitete shoqëria do t'i kryejë duke bere edhe investimet e nevojshme.

Ne te ardhmen objekti i aktivitetit i shoqërisë mund te zgjerohet ose zvogëlohet edhe me aktivitete te tjera te lejuara nga ligji.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 5

Kjo shoqëri do ketë selinë e vet në adresën Rruga "Agron", Zona Kadastrale 8597, Numri i Pasurisë 16/126, Vol.3, Faqe 158, 4001, Shkodër.

KREU 2

Kapitali Themeltar, Organet e Shoqërisë , Administratori ,Eksperti Kontabël dhe Prishja e Shoqërisë

KAPITALI THEMELTAR

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar është në vlerën 6 000 000 lekë (Gjashtë Milion lekë). Kapitali themeltar përbehet nga 2 kuota, te cilat i takojnë ortakeve si vijon:

Ortakët themelues i shoqërisë janë Z. Armand Velaj i cili zotëron 1 kuotë me vlerë të Ortakëve 3 000 000 lekë (Tre Milion lekë) që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë dhe Z. Gjaneto Harusha i cili zotëron 1 kuotë me vlerë të Ortakëve 3 000 000 lekë (Tre Milion lekë) që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ne asamblenë e ortakeve, secili ortak ka te drejtë vote përpjesëtimisht me kuotat që zotëron në kapitalin e shoqërisë, ku çdo ortak ka një vote për çdo 60 000 leke.

Ne rasti te heqjes dore nga kuotat e ndonjërit prej ortakeve, ortakët e tjerë gëzojnë te drejtën e parablerjes mbi kuotat qe ai proporcionalisht me kuotat qe zotëron mund t'i blejë ato tërësisht ne rast se ortaku tjetër nuk e ushtron këtë te drejte.

Shoqëria çel llogari bankare në monedhën vendase (lek) si dhe çdo lloj valute tjetër në banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiarë të aktivitetit të saj.

Ortakët dhe administratori të caktuar nga shoqëria depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në bankat ku është çelur llogaria.

NENI 7

Transferimi i kuotave përkatëse, tërësisht ose pjesërisht behet:

- a) Lirisht ndërmjet ortakeve.
- b) Me trashëgimi, ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet te para dhe paslindurve. Në këto raste asambleja e ortakeve mund të vendose për kushtet e transferimit, të cilat nuk mund të jene me pak të favorshme se për te tretet.
- c) Personave të trete, me aprovimin e një shumice prej $\frac{3}{4}$ të kuotave të kapitalit.

Asambleja e ortakeve ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht ose tërësisht kontributet e saj përfshirë edhe fondet e kontributet në natyrë.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të jenë të vërtetuara me akt noterial dhe për një gjë të tillë asambleja e Ortakëve duhet të marrë paraprakisht vendim me shkrim.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të rritet ose të zvogëlohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asamblesë së Ortakëve, por ai nuk mund të zbrësë nën kufirin minimal të caktuar nga ligji. Ky vendim i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në regjistrin përkatës.

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve shoqëria ka të drejtën që një pjesë të kuotave të kapitalit themeltar t'ia tjetërsojë një apo disa personave fizikë jashtë shoqërisë ose personave juridik, vendas apo të huaj mbi bazën e Aktit noterial të tjetërsuar .

Çdo vendim i Asamblesë së Ortakëve për ndryshim të kapitalit themeltar i dërgohet menjëherë QKB-së.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet në këto mënyra:

- a) Me sjelljen e drejtpërdrejtë nga ortakët në kapitalin e shoqërisë në proporcion me kuotat e tyre në kapitalin shoqëror.

- b) Me përdorimin e fitimit të pashpërndarë me pare ose me përdorimin e fondit rezerve.
- c) Me çdo mënyrë tjetër të lejuar nga ligji.

NENI 9

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i përfaqësuar me letra me vlerë dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet pas kërkesës së drejtuar në QKB për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

Pjesët e kapitalit mund të transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht.

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

NENI 10

Çdo ortak ka të drejte:

- a) Te marre pjese ne aktivitetin e shoqërisë.
- b) Te përfitojë nga fitimi i realizuar ne një mase proporcionale me kuotat e zotëruara prej tij ne kapitalin e shoqërisë.
- c) Te informohet dhe konsultohet me librat e shoqërisë.
- d) Te kërkojë nga gjykata anulimin e vendimeve te asamblesë se ortakeve, për te cilat ai mendon se janë ne kundërshtim me ligjin dhe me këtë statut.

Çdo ortak ka për detyre:

- a) Te derdhe kuotën e tij ne kapitalin e shoqërisë.
- b) Te njohe dhe zbatoje dispozitat e këtij statuti.
- c) Te marre pjese ne administrimin e aktivitetit te shoqërisë.
- d) Te veproje për arritjen e qëllimit te shoqërisë.
- e) Te mbikëqyrë zbatimin e vendimeve te marra nga asambleja e ortakeve.
- f) Te marre pjese, ne përpjesëtim me kuotën e tij te kapitalit, ne përballimin e humbjeve.

Pjesëmarrja ne shoqëri pushon ne rast se:

- a) Vdekjes se ortakut.
- b) Paaftësisë për shkak sëmundje mendore.
- c) Likuidimit vullnetar te shoqërisë.
- d) Falimentimit te shoqërisë.
- e) Largimit vullnetar nga shoqëria.
- f) Ne raste te tjera te përcaktuara nga ligji.

4

Vlera e kuotës dhe fitimit të ortakut në rastet e parashikuara nga gjerat a, b dhe d të pushimit të pjesëmarrjes, përcaktohet në bazë të rezultatit kontabël në fund të muajit në të cilin ka ndodhur ngjarja.

Aprovimi i ortakëve të rinj përcaktohet nga asambleja pas shqyrtimit të një kërkesë përkatëse me shkrim nga i interesuari, në të cilën përveç të tjerave pranon edhe normat e këtij statuti.

Largimi i ortakut bëhet pas shqyrtimit të kërkesës përkatëse me shkrim. Në këtë rast shoqëria duhet të llogarisë kuotën e kapitalit dhe fitimin që duhet të likujdojë ortakut që largohet.

Largimi i një ortaku, nuk e përjashton atë nga detyrimet e kërkueshme deri në datën e largimit nga shoqëria.

Pasuria e shoqërisë është në pronësi të ortakëve përpjesëtimisht me kuotat e tyre në kapitalin e shoqërisë.

Kuotat e kapitalit mund të transferohen me anë trashëgimie, duke u zbatuar dispozitat ligjore për trashëgiminë në ditën e transferimit.

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 11

Organet e Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Ortakëve.
- b) Administratori
- c) Ekspertët Kontabël / Financiare.

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë drejtues dhe vendimor i shoqërisë dhe ajo ushtron të gjitha kompetencat që ligji "Për shoqëritë tregtare: i njëj asamblesë së ortakëve.

Asambleja e Ortakëve mund t'ia delegojë kompetencat një ose shumë administratorëve caktuar prej saj dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë vetëm mbi bazën e prokurës.

5

Me vendim të Asamblesë shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë shtetas shqiptarë apo të huaj ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda dhe jashtë vendit.

Asambleja e Ortakëve e shoqërisë vendos:

- ❖ Mbi ndryshimet në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.
- ❖ Mbi formimin e filialeve degëve dhe përfaqësive jashtë vendit.
- ❖ Mbi përcaktimin e përputhmë risë se investimeve te nevojshme me zhvillimin e aktivitetit te shoqërisë.
- ❖ Mbi rritjen apo zvogëlimin e kapitalit themeltar.
- ❖ Mbi ndryshimet në objekt dhe mbi blerjen e pjesëve të kapitalit në shoqëri të tjera.
- ❖ Mbi transferimin dhe revokimin e likuidatorëve.
- ❖ Mbi mënyrën e operimit me mjetet financiare monetare.
- ❖ Mbi përfitimin nga rezultatet, përcaktimi i përqindjes se rezervës se kapitalit për zhvillim, fond rezerve, etj.
- ❖ Mbi emërimin dhe shkarkimin e Administratorit.

Asambleja vendos me shumice votash qe përfaqësojnë shumicën e kapitalit te shoqërisë, me përjashtim te rasteve kur ligji kërkon një shumice te cilësuar.

Është e detyrueshme shumica e cilësuar prej $\frac{3}{4}$ te kapitalit shoqëror ne këto raste:

- a) Transferimi i kuotave te tretëve.
 - b) Ndryshime ne statut.
 - c) Pakësimi ose shtimi i kapitalit.
 - d) Ndryshimi i shoqërisë ne shoqëri anonime.
- ❖ Asambleja është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme sipas ligjit.
 - ❖ Asambleja e zakonshme mblidhet te paktën një here ne vit.
 - ❖ Ajo mund te thirret edhe jashtë qendrës se shoqërisë.
 - ❖ Thirrja e asamblesë behet nga administratori dhe mund te kërkohet edhe nga një ose me shume ortake qe përfaqësojnë me shume se 10 përqind te kapitalit te shoqërisë.
 - ❖ Thirrja e asamblesë behet me ane te letrës rekomande ose me çdo mjet tjetër, ne mënyrë qe ortaket te njoftohen te paktën 15 dite përpara datës se mbledhjes.
 - ❖ Gjithsesi, mbledhja konsiderohet e vlefshme, ne rast se te gjithë ortaket janë prezentë ose te përfaqësuar.
 - ❖ Një ortak mund te përfaqësohet nga një ortak tjetër, por ai nuk mund ti delegoje përfaqësuesit te drejtën te votoje për një pjesë te kapitalit duke ruajtur për vete pjesën tjetër.

6

NENI 12

Kjo shoqëri administrohet nga administratori Znj. Olta Velaj e identifikuar me numër personal J15826082Q e cila emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar, nga data 02.12.2024 deri me datë 02.12.2029, me të drejtë ndryshimi me konsensusin e ortakëve.

Ai përfaqëson shoqërinë para shtetit dhe privateve.

Administratori ka për kompetence te veproje ne emër dhe për llogari te shoqërisë kundrejt te tretëve, me përjashtim te kompencave qe ka asambleja e ortakeve.

Nder detyrat e administratorit janë edhe këto:

- a) Te kryeje ne emër dhe për llogari te shoqërisë veprime si: lidhja e kontratave dhe marrëveshjeve, përfaqësimi i shoqërisë ne organet dhe entet shtetërore, administrative, ekonomike, gjyqësore, financiare, fiskale, doganore, kundrejt personave juridike dhe kundrejt shtetasve. Këto veprime ai mund ti kryeje vete ose edhe me përfaqësues me ane te prokurës.
- b) Te kujdeset për hartimin e librave dhe regjistrave te shoqërisë, ne te cilat regjistrohen pasuritë e shoqërisë dhe aktiviteti i saj si dhe te kujdeset për hartimin e bilancit te shoqërisë.
- c) Ai është i detyruar te informoje asamblenë e ortakëve për aktivitetin e tij gjate periudhës ndërmjet dy mbledhjeve te saj.

Asambleja e ortakëve ka te drejte te ndryshoje dhe te anulojë veprimet e administratorit, te cilat nuk përputhen me ligjin dhe me këtë statut, duke vendosur edhe pasojat ndaj te tretëve ne mënyrë qe këto te jene minimale.

Shoqëria nuk përgjigjet për veprimet ndaj te tretëve ne rast se provohet qe ata ishin ne dijeni te faktit qe akti i administratorit nuk ishte ne përputhje me ligjin ose me statutin.

Ne kontrata te përgjithshme ose me karakter te rëndësishëm është e nevojshme te merren edhe miratimi i asamblesë. Ky miratim mund te merret edhe me vone dhe ka fuqi prapavepruese.

EKSPERTI KONTABËL

NENI 13

Veprimet ekonomike financiare të shoqërisë mbyllen me datë 31 dhjetor të çdo viti. Për nxjerrjen e rezultatit kontabël mbi bazën e aktivitetit dhe pasivitetit ngarkohet nga asambleja e Ortakëve një ekspert kontabël i autorizuar.

Ekspertet emërohen duke i zgjedhur ndërmjet personave të besuar dhe me aftësi profesionale, jashtë bashkësisë së ortakeve, me përjashtim të atyre që ndalohen nga ligji.

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë zbatimin e normave ligjore në mbajtjen e rregullt të regjistrave dhe plotësimin e sakte të operacioneve të ndryshme e për të gjitha këto i raporton asamblesë së ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit me shkrim, nxjerrjen rezultativ të bilancit vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara e cila është e detyruar t'ia paraqesë dhe dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

Nxjerrja e rezultateve të bilancit vjetor duhet bërë me saktësi duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen nga ligji për kontabilitetin dhe atyre të sistemit të taksave që janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo subjekt privat që ushtron veprimtari tregtare.

Asambleja e ortakeve përcakton shpërblimet që u takojnë ekspertëve dhe administratorit.

Shpërblimet për personelin vartës përcaktohen nga kontratat e punës të lidhur ndërmjet shoqërisë, si punëdhënëse dhe punonjësit.

AKTIVITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR I SHOQERISE

NENI 14

Detyra e shoqërisë si dhe qëllimi i saj është që të mbulojë shpenzimet dhe të realizojë fitime.

Për të plotësuar qëllimin e saj, shoqëria mund të kryejë veprime të natyrës të luajtshme, të paluajtshme dhe tregtare, si:

- a) Te hapë llogari pranë bankave si dhe institucioneve të tjera të kreditit.
- b) Te marrë hua e kredi nga institucione krediti, ose të tjera si këto.
- c) Te lidhë kontrata e marrëveshje sipas ligjit dhe leverdisë ekonomike
- d) Te hapë filiale, dege, agjenci, përfaqësi në rrethe të tjera të vendit.
- e) Te ketë dhe të administrojë pasuri të ndryshme, të luajtshme e të paluajtshme. Këto të fundit regjistrohen në organet përkatëse në baze të rregullave të përcaktuara me ligj.
- f) Viti financiar hapet me 1 janar dhe mbyllet 31 Dhjetor të çdo viti.
- g) Brenda tre muajve nga mbyllja e tij, administratori duhet të marrë masa për hartimin e bilancit, ku të evidentohen të ardhurat dhe fitimi.
- h) Asambleja e ortakeve për miratimin e bilancit thirret brenda katër muajve nga mbyllja e vitit financiar dhe për motive shume të veçanta, brenda gjashte muajve.

8

- i) Te ardhurat e realizuara i nënshtrohen te gjitha tatimeve e taksave te përcaktuara nga ligji shqiptar.
- j) Fitimi i nënshtrohet një shume jo me pak se pese përqind për fond rezerve. Kjo klauzole nuk është e detyrueshme, ne rast se përqindja e kapitalit te rezervës arrin ne 10 përqind te kapitalit themeltar.
- k) Kontabiliteti mbahet ne gjuhen shqipe dhe sipas ligjeve shqiptare.
- l) Humbjet qe rezultojnë, do te mbuloohen nga fondi rezerve dhe ne rast se ai është i pamjaftueshëm, nga po ky fond i destinuar për 5 vjet.
- m) Asambleja e ortakeve mund te vendose për forma te tjera te mbulimit te humbjeve.
- n) Kur nga humbjet e realizuara, kapitali mbetet me pak se kufiri minimal i përcaktuar ne ligj, brenda tre muajve asambleja e ortakeve duhet te vendose për mbulimin e tyre dhe vijueshmërinë e shoqërisë. Ne rast te kundërt çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës duke kërkuar prishjen dhe likuidimin e shoqërisë.
- o) Bilanci kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asamblesë së Ortakëve e cila jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj duke patur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te veçantë etj.

ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

NENI 15

Ne rast te mosmarrëveshjeve ndërmjet ortakeve dhe/ose trashëgimtareve te tyre, asambleja e ortakeve do te përpiqet ti zgjidhe ato me mirëkuptim.

Ne rast se mirëkuptimi nuk arrihet, mosmarrëveshjet zgjidhen ne rruge arbitrazhi sipas neneve 400 e vijues te Kodit te Procedurës Civile ose ne rruge gjyqësore, duke zbatuar normat procedurale.

Mosmarrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe te tretëve ose ndërmjet shoqërisë dhe te punësuarve te saj, ne rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do te zgjidhen ne rruge gjyqësore sipas ligjit.



9



PUSHIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

NENI 16

Shoqëria pushon aktivitetin e saj të mëtejshëm të veprimtarisë së saj një nga mënyrat e parashikuara nga ligji "Për falimentimin" kur:

- a) Kur përfundon afati i përcaktuar ne statut.
- b) Me vendim unanim te asamblesë se ortakeve.
- c) Për shkak te pushimit te aktivitetit.
- d) Për shkak te shkrirjes dhe bashkimit me shoqëri te tjera
- e) Me falimentim.
- f) Me vendim gjyqësor ne rastet e përcaktuara me ligj.
- g) Ne te gjitha rastet e tjera te caktuara ne ligj.

Ne vazhdim asambleja e ortakeve emëron një ose me shume administratore. Ne te kundërt, është gjykata ajo qe emëron likuidatorët dhe përcakton për përfundimin e likuidimit. Në këto raste Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një ose disa likuidatorë dhe duke shënuar ne çdo dokument të nxjerrë prej tij dhe emërtesën "Shoqëri në likuidim e sipër".

Afati i emërimit të likuidatorit publikohet sipas kushteve që parashtron ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentet që duhen depozituar në aneksin e regjistrit në QKB.

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet vendimeve plotësuese dhe të ligjshme, dhënë nga Asambleja e Ortakëve si dhe legjislacioni në fuqi.

Ne përfundim te likuidimit, mbetja qe rezulton i ndahet ortakeve proporcionalisht me kuotat e tyre ne shoqëri. Ne te njëjtën mënyrë përballohen edhe humbjet.

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkakut edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar siç mund të jenë, Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit.

Shoqëria nuk pushon aktivitetin e saj, ne rast se ndonjëri nga ortaket vdes, falimenton ose behet i paafte për shkak sëmundje mendore.

10

DISPOZITAT E FUNDIT

NENI 17

Të ardhurat neto (dividendi) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi ortakëve të shoqërisë sado qofshin ato.

Problemet e punësimit në shoqëri përcaktohen dhe rregullohen sipas legjislacionit shqiptar të punës, duke lidhur kontratat përkatëse.

Te gjitha problemet që nuk janë trajtuar në këtë statut, do të zgjidhen sipas dispozitave përkatëse në fuqi në kohën e lindjes së nevojës për zbatim.

Ky status, si dhe dokumentet e tjera themeluese të kësaj shoqërie janë hartuar në baze të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe në ligjin nr. 131 i datës 26.11.2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit",

Në rast të ndryshimeve të legjislacionit, që mund të sjellin si pasoje mospërputhjen e statutit me ligjin do të rishikohen dhe do të modifikohen.

ORTAKËT THEMELUES

TË SHOQËRISË

G&A CONSTRUCTION GROUP SHPK

Armand Velaj

ARMAND VELAJ



Gjaneto Harusha

GJANETO HARUSHA

